



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1278/2 Prot.

Tiranë, më 06.10.2025

V E N D I M

Nr. 231, Datë 06.10.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 190, datë 04.09.2025, e riparaqitur me email-et datë 15.09.2025 dhe 02.10.2025¹, e bërë nga znj. Gj.M kundër Bashkisë Vau Dejës/Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social, me pretendimin për diskriminim, për “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularët e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Gj.M është viktimë e dhunës sistematike fizike dhe psikologjike nga bashkëshorti i saj L.M, i cili është dënuar penalisht për “dhunë në familje” dhe ndaj të cilit gjykata ka lëshuar urdhër mbrojtjeje dhe masa të përkohshme, lidhur me kujdestarinë e fëmijëve, që nën kujdes alternativ i janë besuar me vendim, kunatës së Gj. znj. D.Gj. Aktualisht Gj dhe L janë në proces divorci dhe kërkesë për kujdestarinë e fëmijëve. Megjithëse ekziston një vendim gjyqësor i qartë, shërbimet sociale kanë treguar neglizhencë të theksuar duke mos zbatuar masat e vendosura dhe duke mos siguruar mbrojtjen e nevojshme për të dhe fëmijët e saj.

Pas daljes nga spitali psikiatrik, ku u shtrua në mënyrë të imponuar, Gj nuk iu garantua trajtimi i detyrueshëm psikologjik i rekomanduar nga specialistët, por përkundrazi iu administruan medikamente të papërshtatshme që e rënduan gjendjen e saj emocionale, duke i shkaktuar plogështi, ankth dhe stres shtesë. Trajtimi psikologjik ishte i detyrueshëm sidomos pas daljes nga

¹ Formulatat e ankesës të dërguar në datë 04.09.2025 dhe me email-in datë 02.10.2025, nuk janë të firmosur nga ankuesja.

² Pa përcaktuar një veçori apo karakteristikë personale.

spitali dhe akomodimin e saj në qendrën sociale “Besa”, ku aktualisht nuk merr asnjë trajtim të psikologut nga shërbimet sociale.

Përveç kësaj, në vend që të sigurohej sistemim i qëndrueshëm në një banesë, ajo është zhvendosur disa herë nga një strehë në tjetrën, duke i krijuar pasiguri të vazhdueshme dhe mungesë stabiliteti për të ardhmen e saj dhe të fëmijëve.

Një tjetër element shqetësues është fakti që shërbimet sociale nuk kanë garantuar kontaktet e rregullta të saj me fëmijët, ndonëse gjykata nuk ia mohon dhe ligji ja njeh këtë të drejtë. Përkundrazi, është lejuar që fëmijët të mbahen nga babai dhe familja e tij, në kundërshtim të hapur me vendimin gjyqësor për kujdestarinë alternative (dhe pa marrë parasysh faktin që ai është i dënuar për dhunë në familje, dhe fëmijët kanë qenë viktimë të dhunës së asistuar). Përpjekjet e saj për të kontaktuar fëmijët janë penguar nga kunata, e cila që nga data 19.07.2025, ka bllokuar të gjitha thirrjet nga Gj, ndërsa shërbimet sociale nuk kanë ndërhyrë për të zbatuar vendimin dhe për të mbrojtur interesin më të lartë të të miturve.

Gj dhe përfaqësuesja e saj ligjore nuk janë njoftuar në kohë me shkrim për disa vendime gjyqësore, ndërsa seanca gjyqësore mbi kujdestarinë është zhvilluar në mungesë të saj, kur ajo ndodhej e shtruar në spital. Gjithashtu ata nuk janë njoftuar me shkrim as për vendimin dhe as pajisur me relacionet mbi ecurinë e rastit të cilat i janë kërkuar shërbimeve sociale që në nëntor të vitit 2024, që në fillimin e procesit për zgjidhje martesë.

Për më tepër, shërbimet sociale nuk i janë përgjigjur kërkesave të përsëritura për strehim dhe mbështetje, duke e kufizuar qëndrimin e saj në azil dhe duke i komunikuar verbalisht se “nuk do të ndihmohej më”, në kundërshtim me detyrimet ligjore të tyre dhe vendimin e gjykatës që parashikon mbështetje të plotë. Kjo neglizhencë ka rënduar gjendjen e saj psikologjike dhe ka dëmtuar marrëdhënien nënë-fëmijë, duke rrezikuar zhvillimin emocional të fëmijëve që ndodhen në mjedise ku dyshohet për dhunë dhe abuzim emocional, madje edhe fizik.

Kjo situatë ka përkeqësuar traumën e saj, ka dëmtuar raportin nënë-fëmijë dhe ka rrezikuar mirëqenien e dy fëmijëve të mitur, të cilët duhet të ishin prioritet absolut i mbrojtjes sociale dhe ligjore. Ekzistojnë arsye serioze për të menduar që fëmijët jetojnë dhunë psikologjike në familjen ku qëndrojnë aktualisht. Këtë e provon dhe fotot bashkangjitur ku fëmijët tregohen në foto që po ushqehen, ndërkohë që kanë qarë dhe në tavolinë ndodhet një thupër gjysmë metri. Fëmijët janë shkëputur brutalisht nga nëna duke dëmtuar dhe atashimin nënë fëmijë, dhe në mesazhet bashkangjitur provohet dhe komunikimi i ndërprerë nga ana e znj. D.Gj, që për shkaqe të renditura si më lart, është kallëzuar në Prokurori. Dhuna emocionale dhe psikologjike ndaj fëmijëve duke i ndarë me nënën dhe dhunuar në mungesë të saj, janë pasoja të drejtpërdrejta të neglizhimit nga ana e shërbimeve sociale.

Fëmijët edhe pse kanë mbushur moshën 3 vjeçare janë neglizhuar duke mos i regjistruar në kopsht (në një kohë që kur ishin me nënën e tyre shkonin në çerdhe). Ato duke shkelur vendimin janë lënë për periudha të gjata kohore tek babai, i dënuar me arrest shtëpie në një kohë që nuk i është treguar kujdes edukimit të tyre, dhe pavarësisht qëndrimit me babain, duhet të

kemi parasysh dy gjera, që gjithsesi mbetet i dënuar dhe për dhunë në familje ku fëmijët kanë qenë dhe viktimat e asistuara dhe që kanë qenë të pranishëm në incidentet e rënda të dhunës, madje edhe objekt.

Në fletën e daljes provohet që shtrimi i Gj nga Shërbimet Sociale ka qenë i qëllimshëm për t'i hequr vetes përgjegjësitë në lidhje me akomodimin. E para, nga fletëdalja e psikiatrikut rezulton që Gj vuan nga çrregullime të personalitetit dhe ka diagnozë të lehtë të Border Line. Medikamentet që ka marrë në strehëza, diagnostikuar gabim e kanë rënduar dhe vënë në gjendje plogështie, duke e bërë të varur nga ilaçet. Në relacionin e psikologëve rezulton dhe lloji i “kurës” që ka marrë, ndërkohë që nga fletëdalja e spitalit, rezulton që nuk duhet trajtuar me medikamente por është i nevojshëm trajtimi sistematik dhe terapia nga psikologu (i cili nuk i është vënë në dispozicion nga shërbimet sociale, duke i shkaktuar dëme shëndetësore Gj e cila përjeton vazhdimisht gjendje nervozizmi, ankthi dhe stresi).

Me datë 19.09.2025, është zhvilluar një takim me ndërmjetësimin e zyrës së Avokatit të Popullit, Gj me ekspertin e Ministrisë së Drejtësisë, ku ndër të tjera u diskutuar dhe problemi i mungesës së përgjegjësisë nga shërbimet sociale, në lidhje me takimet e fëmijëve, siç i përmendëm më lart; strehimit dhe nevojës së diktuar nga specialistët për trajtimin e Gj përmes shërbimit psikologjik. Ju rekomandua nga ekspertja komunikimi me linjën e këshillimit Tiranë, por që mbetet diçka e përkohshme sepse Gj ka nevojë për kontaktin e psikologut nga afër, dhe kjo mbetet përgjegjësi e shërbimeve sociale të cilët kanë urdhëruar shtrimin.

Dhe së fundmi, në lidhje me strehimin, Gj nuk është praktike në lidhje me aplikimin e strehimit, për këtë duhet të tregonte kujdes zyra e shërbimeve sociale, ku Gj dhe i ati kanë kërkuar vazhdimisht që ti ndihmojnë në lidhje me strehimin dhe akomodimin e saj. Një gjë e tillë shërbimit social i është rekomanduar dhe nga Gjykata, duke qenë se Gj është përfutuese si viktimë e dhunës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rivendosjen e kontakteve me fëmijët.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 24.09.2025, drejtuar Avokates E.G, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, shpjegime, fakte dhe prova për të identifikuar shkakun “çdo shkak tjetër” dhe kopje të kërkesave të përsëritura për strehim dhe mbështetje që ka bërë pranë Shërbimeve Sociale.

Avokate E.G³, në emër të ankueses, me email-in datë 02.10.2025 dërgoi shtesë informacioni, por nuk dërgoi dokumentacion lidhur me shkakun e pretenduar.

³ Në aktet e dorëzuara pranë Komisionerit, nuk disponohet prokurë apo deklaratë përfaqësimi të znj. Gj.M, për Avokaten E.G.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Vendimmarrja e KMD-së arsyetohet dhe argumentohet mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “*çdo shkak tjetër*”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të saj.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut të mbrojtur”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

Përsa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë shkaqesh. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferenat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se pretendimi i ankuses për diskriminim, në mungesë të specifikimit të një shkak apo të një karakteristike personale të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur” sipas ligjit 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, (siç janë: *raca, etnia, ngjyra, gjuha, shtetësia, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, karakteristikat e seksit, jetesa me HIV/AIDS, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, mosha, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamja e jashtme, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, apo çdo karakteristikë tjetër e mbrojtur nga ligji*), e vështirëson procesin e vlerësimit të rrethanave si diskriminuese në kuptimin ligjor.

Ekzistenca e një shkak të mbrojtur është një element thelbësor për të vlerësuar nëse trajtimi i pretenduar përbën një shkelje të mundshme të të drejtave të personave në formën e diskriminimit. Për rrjedhojë, në mungesë të provave të mjaftueshme që lidhen drejtpërdrejt me ndonjë shkak të mbrojtur ligjërisht, ankesa nuk përmbush kriteret ligjore për të vijuar më tej si një çështje diskriminimi në kuptimin e nenit 3 dhe 3/1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse:, ç) ... është haptazi e*

pabazuar”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁵.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të subjektit ankues znj. Gj.M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ Për analogji citojmë vendimet: nr. 283, datë 19.11.2024, nr. 84, datë 14.04.2025 dhe nr. 229, datë 01.10.2025, të KMD-së.